



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 6 Mars 2023

Nr: 95

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË KORÇË, PËR
RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 6 Mars 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Zj. Mariana Jorgji, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Korçë

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Korçë, për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 28.1.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 2 (dy) veprimtarive publike nga ana e bashkisë Korçë.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

Data: 6 Mars 2023

Nr: 95
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Korçë, për raportimin e veprimtarive publike”

1. *“Me ftesë të bashkisë Korçë dhe mbështetjen e Ministrisë së Turizmit dhe Unionit Turistik Shqiptar, kanë qenë sot në Korçë përfaqësuesit e agjencive më të mëdha turistike të Shqipërisë e Kosovës, përfaqësues të bizneseve të turizmit në rajon dhe aktorë e ekspertë të rëndësishëm kombëtarë në këtë fushë”*

Link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=733141528177175&set=pcb.733142244843770>

Veprimtaria publike rezulton të jetë transmetuar në 2 (dy) media publike.”

2. *“Isha sot në një nga Qendrat e të Moshuarve që bashkia ka hapur në Korçë, për të biseduar me ta dhe për t’i siguruar se edhe mbështetja e bashkisë për këtë grupmoshë do të vijojë jo vetëm me Kartën e Pensionistit dhe Qendrat Komunitare, por edhe me programe e projekte të tjera që kanë për qëllim shtimin e shërbimeve dhe lehtësimin e jetës së tyre”*

Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=729908855167109&set=pcb.729908251833836>

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, pasi u shqyrtua paraprakisht çështja, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Më datë 16.2.2023, bashkisë Korçë, i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 17.2.2023, bashkia Korçë ndër të tjera bën me dije se: *“...Duke qenë se ishim në pritje të hapjes së kredencialeve nga ana juaj gjë që deri tani nuk është bërë e mundur dhe pas disa përpjekjeve për të raportuar me anë të email zyrtar, duke filluar nga data 3 Shkurt 2023 e në vazhdim u bë i mundur raportimi i veprimtarive publike të kryetarit të bashkisë Korçë, në adresën e vendosur në dispozicion nga ana juaj.*

Po ju vendosim në dispozicion informacionin në lidhje me dy aktivitetet e përmendura në email:

1. *Me iniciativë të Ministrisë së Turizmit, në datë 25 Janar 2023, ora 11:30, tek Hotel "Park Plaza" është zhvilluar një takim me përfaqësuesit e agjencive më të mëdha turistike të Shqipërisë e Kosovës, përfaqësues të bizneseve të turizmit në rajon dhe aktorë e ekspertë të rëndësishëm kombëtarë në këtë fushë. Në takim ka qenë i pranishëm kryetari i bashkisë Korçë Sotirag Filo, Zv/Kryetare Benila Themeli, përfaqësues nga institucionet lokale dhe përfaqësues të gjashtë bashkive të Qarkut*

Data: 6 Mars 2023

Nr: 95
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Korçë, për raportimin e veprimtarive publike”

Korçë. Qëllimi i takimit ishte diskutimi për krijimin e paketave turistike rajonale me synim zhvillimin e turizmit rajonal si edhe promovimi i tyre nga tour operatorët turistikë.

- 2. Në datë 20 Janar 2023, ora 11:45, kryetari i bashkisë së bashku me drejtoreshën e Drejtorisë së Kujdesit Social, kanë zhvilluar një takim në një prej Qendrave Ditore të të Moshuarve të cilat administrohen nga bashkia për të diskutuar rreth problematikave dhe nevojave të kësaj grupmoshe.”*

Nga verifikimi i të dhënave, fakteve dhe rrethanave të marra në shqyrtim nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vlerësohet se problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive jashtë vullnetit të organit publik.

Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësoj se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ për ato shkelje që lidhen me çështjen objekt shqyrtimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Korçë, nuk përbën shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj zj. Mariana Jorgji, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Korçë.
2. Tërheqje vëmendje ndaj bashkisë Korçë, për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.

Data: 6 Mars 2023

Nr: 95
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Korçë, për raportimin e veprimtarive publike”

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 6 Mars 2023

Nr: 95
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Korçë, për raportimin e veprimtarive publike”